

Bazuar në nenin 18 paragrafi (1) pika 16 dhe nenin 20 paragrafi (1) pika 11, dhe në lidhje me nenin 22 paragrafi (6) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14), neni 15 paragrafi (1) pika 15 dhe neni 39 paragrafi (1) pika 11 të Rregullores për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.01-4351/1 datë 29.08.2014, në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr.02-2692/3 datë 6.4.2015, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në seancën e 15- të e mbajtur më 6.4.2015, miratoi

Kodeks për sjelljen e anëtarëve të Këshillit dhe të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me Kodeksin për sjelljen e anëtarëve të Këshillit dhe të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (në tekstin e mëtejshëm „Kodeks“), përcaktohen parimet bazë të sjelljes dhe punës së anëtarëve të Agjencisë, drejtorit të Agjencisë, zëvendës drejtorit të Agjencisë dhe të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë (në tekstin e mëtejshëm „të punësuarit“), me qëllim të sigurojë respektimin e ligjshmërisë, integritetin profesional dhe efektivitetin gjatë kryerjes së funksioneve dhe detyrave të përcaktuara në dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Ligjit për media dhe akteve nënligjore të Agjencisë.

Anëtarët e Këshillit, drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë dhe të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, kanë për detyrim t'i përmbahen dispozitave të këtij Kodeksi.

Neni 2

Qëllimet e këtij Kodeksi:

- për të përcaktuar dhe rënë dakord mbi rregullat bazë etike të sjelljes së anëtarëve të Këshillit të Agjencisë, drejtorit të Agjencisë, zëvendës drejtorit të Agjencisë dhe të punësuarve;
- për rritjen e efikasitetit, transparencës dhe përgjegjësinë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në zbatimin e funksioneve dhe ingjencave të përcaktuara me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Ligjin për Media;
- për të nxitur dhe forcuar përcaktimin personal të anëtarëve të Këshillit të Agjencisë, drejtorit të Agjencisë, zëvendës drejtorit të Agjencisë dhe të punësuarve, për të qenë të pavarur dhe të paanshëm gjatë miratimit të vendimeve dhe realizimit të detyrave të tyre;
- për të ruajtur dhe rritur besimin në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale;
- për të siguruar cilësi të lartë dhe procedurë të thjeshtë për përmbushjen në kohë dhe profesionalisht të detyrave ndaj botuesve të medias, ofruesve të shërbimeve audio dhe audiovizuale dhe operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik.
- për të parandaluar shfaqjen dhe pranimin e procedurave joetnike të sjelljes së anëtarëve të Këshillit të Agjencisë, drejtorit të Agjencisë, zëvendës drejtorit të Agjencisë dhe të punësuarve.

II. DEFINICIONE

Neni 3

Shprehjet dhe termet e ndara të përdorura në Kodeks kanë kuptimin si vijon:

- Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale është trup rregullator i pavarur dhe joprofitabil me statusin e personit juridik me (autorizim) ingjerenca publike në lëmin e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale;
- Të punësuar — janë të gjithë personat që në shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale janë të punësuar me kontratë pune me afat të caktuar dhe kontratë pune me afat të pacaktuar si dhe kontratë për punësim të përkohshëm;
- Përplasje interesash — nënkupton përplasje të autorizimeve publike dhe detyrimeve me interesin personal të anëtarëve të Këshillit, drejtorit të Agjencisë, zëvendës drejtorit të Agjencisë ose të punësuarve në shërbimin profesional, që ndikon ose mund të ndikojë në ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të tyre;
- Interesi indirekt — nënkupton interesat e anëtarëve të familjes në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale e anëtarit të Këshillit të Agjencisë, drejtorit të Agjencisë, zëvendës drejtorit të Agjencisë ose të punësuarve në shërbimin profesional.

III. PARIME TË PËRGJITHËSHME

Neni 4

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë, drejtorin e Agjencisë, zëvendës drejtorin e Agjencisë dhe të punësuarit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre përkatësisht detyrave të punës, detyrohen se:

- Do të angazhohen për zbatim në mënyrë konsekuente të dispozitave nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Ligjin për media, akteve nënligjore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe dispozitave të tjera ligjore me të cilën rregullohen lëmitë Audio dhe Audiovizuale;
- Dhe kujdesi për mbrojtjen e interesit publik dhe përmbushjen e interesave të qytetarëve në lëminë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale;
 - Ata udhëhiqen nga parimi i paanshmërisë dhe pavarësisë ndaj çdo interesi politik ose ekonomik;
 - Ata do t'i përkushtohen realizimit të funksioneve Ligjore dhe kompetencave të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe do të kujdesen për ruajtjen e integritetit dhe prestigjin e saj;
 - Do të kujdesen për standarde më të larta profesionale në punë dhe për profesionalizëm, ndershmëri, ndërgjegjshmëri, përgjegjësi dhe efikasitet në kryerjen e detyrave dhe obligimeve; _ statusin ose ndikimin e tij, nuk do të përdoren për përmbushje të interesave personale dhe materiale, si dhe për interesat e familjarëve të tyre;
 - Do të sigurojnë trajtim të njëjtë dhe korrekt si dhe trajtim të drejtë ndaj të gjithë personave juridikë dhe fizikë, kërkesat e të cilëve janë lëndë shqyrtimi;

2

- Nuk do të angazhohen në çfarëdo aktiviteti që është përcaktuar si konflikt interesi në pajtim me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Ligjin për media, dhe dispozitave të tjera Ligjore dhe ky Kodeks; _ drejtpërdrejtë dhe indirekt nuk do të ketë parësi ose përkrahin ndonjë dhuratë, send ose dobi tjetër nga persona për të funksionuar ose mos funksionuar në shërbim të Agjencisë;
 - _ Dë të respektohen të drejtat dhe dinjiteti i tjetrit.

IV. PAVARËSIA DHE PAANSHMËRIA

Neni 5

Gjatë vendimit për të gjitha pyetjet që rrjedhin nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, anëtarët e Këshillit të Agjencisë, drejtori i Agjencisë dhe zëvendës drejtori i Agjencisë, do të udhëhiqen nga vlerësime objektive, të drejta dhe të paanshme në situata aktuale.

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë, drejtori i Agjencisë dhe zëvendës drejtori i Agjencisë, janë të detyruar të mos pranojnë asnjë instruksion ose detyra nga ku/jt qoftë person/at juridik/e ose fizik/e nuk do të ndërmarrin veprime që mund të vënë në pyetje pavarësinë e funksionit të tyre dhe paanshmërinë gjatë vendimmarrjes.

Kontaktet e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë, e drejtorit të Agjencisë, e zëvendës drejtorit të Agjencisë dhe të punësuarit, me personat juridik dhe fizikë në lidhje me kërkesat që janë lëndë e shqyrtimit dhe vendimit, duhet të jenë të kufizuar në komunikimin profesional dhe në funksion të zbatimit profesional të procedurës për zgjidhjen e kërkesave të paraqitura.

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë, drejtori i Agjencisë dhe zëvendës drejtori i Agjencisë, detyrohen të refuzojnë plotësisht dhe menjëherë të gjitha format e presionit që kanë për qëllim të ndikojnë në veprimtarinë e tyre ose vendimmarrje dhe për këtë njoftohet Kryetari i Këshillit të Agjencisë, dhe anëtarët e tjerë të Këshillit të Agjencisë.

Neni 6

Të punësuarit i kryejnë detyrat e tyre të punës në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, duke pasur parasysh situatën aktuale dhe duke i'u përmbajtur procedurës së përcaktuar me Ligj dhe me aktet e Këshillit të Agjencisë .

Të punësuarit janë të detyruar të refuzojnë urdhër që bie në kundërshtim me dispozitat Ligjore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, akteve të tjera ligjore pozitive në Republikën e Maqedonisë, e akteve të Këshillit të Agjencisë dhe të rregullave të përcaktuara nga ky Kodeks, edhe nëse ky presion vjen nga eprori i tyre.

Në situata kur një urdhër është dhënë ose kryhet presion për të vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, dispozitave të tjera pozitive në Republikën e Maqedonisë, e akteve të Këshillit të Agjencisë dhe e Rregulloreve të përcaktuara me këtë Kodeks, të punësuarit janë të obliguar të njoftojnë drejtorin e Agjencisë, kryetarin e Këshillit të Agjencisë dhe anëtarët e tjerë të Këshillit të Agjencisë.

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë, drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë dhe të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë në relacion të ndërsjellë sillen duke treguar respekt për personin.

3

Neni 7

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë, drejtori i Agjencisë dhe zëvendës drejtori i Agjencisë, si edhe të punësuarit nuk duhet ta shfrytëzojnë pozicionin e tyre profesional në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, me qëllim të promovimit të interesave të kujdo partie politike dhe grupi që promovon interesa/aktivitete e kujdo partie politike.

Anëtarët e Këshillit, drejtori i Agjencisë dhe zëvendës drejtori i Agjencisë, si dhe të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit përkatësisht gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në punë, nuk mund të ushtrojnë detyrë partiake në organet e partisë politike.

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë, drejtori i Agjencisë dhe zëvendës drejtori i Agjencisë, si dhe të punësuarit, gjatë gjithë periudhës për të cilën janë përzgjedhur, përkatësisht gjatë gjithë kohës derisa janë në marëdhënie pune në Agjencion, nuk duhet të ushtrojnë aktivitete politike që mund të sjellin në pyetje aftësinë për të ushtruar në mënyrë të paanshme detyrën profesionale, përkatësisht detyrat që do të kenë ndikim neutral në politikë.

V. KONFLIKTET E INTERESIT

3

Член 8

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë, drejtori i Agjencisë dhe zëvendës drejtori i Agjencisë, si dhe të punësuarit, nuk duhet të shfrytëzojnë pozicionin e tyre profesional në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për realizim të interesave personale dhe nuk lejohen të vihen në situatë ku ekziston konflikt interesi personal me interesat e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale,

Neni 9

Konflikte interesi janë të gjitha situatat në të cilat anëtar i Këshillit të Agjencisë, drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë ose i punësuar ka çfarëdoqë interesi direkt ose indirekt me person juridik që ushtron veprimtari nga lëmia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ose në shoqëri që ushtron një veprim të ngjajshëm (agjencion gazetaresk, reklamim dhe propagand, hulumtim i tregut dhe opinionin publik, distribuimin e veprave audiovizuale, produksioni filmik, ritransmetim ose transmetim të programeve në radio/televizion).

Konflikt interesi mund të ekzistojë dhe në situata në të cilat anëtar i Këshillit të Agjencisë, drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë ose i punësuar ka çfarë do interesi direkt ose indirekt në person juridik me të cilin Agjencia ka bashkëpunuar ose duhet të lidhë kontratë për bashkëpunim ose interes me një tjetër person juridik me të cilin Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale realizon bashkëpunim.

Neni 10

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë, drejtori i Agjencisë dhe zëvendës drejtori i Agjencisë, janë të obliguar të informojnë me shkrim Këshillin e Agjencisë, ndërsa të punësuarit Drejtori i Agjencisë, për të gjitha situatat në të cilat ekziston konflikt interesi potencial ose aktual, në kuptim të nenit 9 të këtij Kodeksi.

Kryetari i Këshillit të Agjencisë, nëse ka njohuri që ekziston konflikt interesi potencial ose aktual, mund të kërkojë nga anëtar i Këshillit ose nga drejtori i Agjencisë, ndërsa drejtori i Agjencisë nga i punësuarit, të paraqesë një deklaratë me shkrim për natyrën e interesit që ai/ajo e ka me personin juridik për të cilin bëhet fjalë. Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale diskuton për të gjitha situatat në të cilat ekziston ose mund të ekzistoi konflikt interesi dhe ndërmerr masat përkatëse për zgjidhjen e tyre në pajtim me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Ligjin për Media, dhe Rregulloret e tjera ligjore me të cilat rregullohet kjo materie dhe ky Kodeks.

VI. HYRJE NË INFORMATAT DHE KOMUNIKIMI PUBLIK

Neni 11

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë, drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë dhe të punësuarit «do t'ua lehtësojnë hyrjen në degët e informacionit që lidhen me aktivitetet e Agjencisë që ata kanë të drejtë të marrin, për realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre»

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë, drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë dhe të punësuarit, do të respektojnë besueshmërinë e informacioneve që janë nënvizuar në vend të dukshëm/klasifikuar me shenjë „për përdorim të kufizuar” në pajtim me dispozitat Ligjore dhe Rregulloren për punën e Agjencisë për Shërbime mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.01-4351/1 datë 29.8.2014.

Neni 12

Të gjithë personat juridik dhe fizik që kanë paraqitur korrespondencë drejtuar Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, detyrimisht pra gjithmonë kur është e mundur, do t'u dorëzohet përgjigje me shkrim në pajtim me dispozitat nga Ligji për të vepruar sipas potencialave dhe propozimeve dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit.

Gjatë përgatitjes së materialeve të shkruara, vendim ose aktvendim si dhe në komunikim tjetër me publikun, të punësuarit janë të obliguar të shfrytëzojnë gjuhë të qartë dhe të kuptueshme.

Neni 13

Anëtarët e Këshillit, drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë dhe të punësuarit, gjatë kontaktimit me të gjithë personat juridik dhe fizik, duhet të tregojnë mirëkuptim maksimal, mirësjellje dhe vullnet të mirë me qëllim për t'i ndihmuar në plotësimin e të drejtave dhe interesave të tyre.

Anëtarët e Këshillit, drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë dhe të punësuarit, nuk duhet të diskriminojnë asnjë person për shkak të përkatësisë racore, gjinore, nacionalitetit, përkatësive fetare dhe politike ose për shkak të statusit social, kulturor, gjuhës, orientimit seksual, moshës ose paaftësisë (invaliditetit).

Neni 14

Gjatë kontakteve me publikun të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë do të legjitimohen.

Gjatë kryerjes së kompetencave të tyre zyrtare, të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë, janë të detyruar të mbajnë kartë identifikimi me emrin, mbiemrin dhe fotografinë e tyre.

Neni 15

Mendimet dhe qëndrimet personale të anëtarëve të Këshillit të Agjencisë, të drejtorit të Agjencisë, përkatësisht të zëvendës drejtorit të Agjencisë dhe të punësuarve, për pyetje në kompetenca të Agjencisë, mund të bëhen publike, vetëm nëse qartë është nënvizuar se ai/ajo flet ose shkruan vetëm në emrin e vetë, përkatësisht përcjell vetëm mendimin ose qëndrimin e tij personal.

Duke pasur parasysh, se me mendimet dhe qëndrimet e shprehura personalisht nuk duhet të dëmtojë reputacionin e Agjencisë.

Neni 16

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë, drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë dhe të punësuarit e obliguar për marrëdhëniet me publikun, ndaj gazetarëve dhe përfaqësuesve publikë sillen me respektin e duhur dhe mirëkuptim maksimal për të drejtat dhe obligimet e tyre.

VII. PRANIMI I DHURATAVE DHE PËRFITIMEVE TË TJERA

Neni 17

Anëtarëve të Këshillit, drejtorit të Agjencisë, zëvendës drejtorit të Agjencisë dhe të punësuarve ju ndalohet, në lidhje me punët që kryejnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në emrin e tyre personal (për familjarët e tyre, të afërmit e tyre dhe miq të ngushtë të kërkojnë ose të pranojnë dhurata, shpërblime, kompensim, premtime, shërbime ose përfitime të tjera, nga botuesit e medias, dhënësit e shërbimeve Audio dhe Audiovizuale ose operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik, si dhe nga persona fizikë dhe juridik me të cilët Agjencia realizon bashkëpunim pune.

Përgjashtim nga rregulli nga paragrafi (1) i këtij ligji jkanë sendet individuale me vlerë të vogël (libra, dhurata, stilolapsa dhe sende të ngjajshme), që është shprehje e një mirësjelljeje të zakonshme. Përprjekjet e palëve për të ofruar ndonjë interes në shkëmbim të shërbimit ose trajtim të privilegjuar, anëtarët e Këshillit të Agjencisë, drejtori i Agjencisë dhe zëvendës drejtori i Agjencisë menjëherë duhet ta paraqesë me shkrim tek Kryetari i Këshillit të Agjencisë dhe tek anëtarët e tjerë të Këshillit të Agjencisë, ndërsa të punësuarit deri tek drejtori i Agjencisë.

Neni 18

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nuk siguron dhurata zyrtare ose komoditete të tjera për botuesit e medias, dhënësve të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ose operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik, si dhe personave juridik dhe fizikë me të cilët realizon bashkëpunim pune, me përjashtim të sendeve me vlerë të vogël që është shprehje e një mirësjelljeje të zakonshme pune.

Neni 19

Në rastin e anëtarit të Këshillit, drejtorit të Agjencisë dhe zëvendës drejtorit të Agjencisë ose të punësuarit, t'i ofrohet për të pranuar pllaket ose mirënjohje për aktivitet që lidhet me punën në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ai/ajo duhet të njoftoi Kryetarin e Këshillit dhe drejtorin e Agjencisë, për të vlerësuar nëse pranimi i pllaketit ose mirënjohjes është në pajtim me rregullat e përcaktuara në këtë Kodeks.

Neni 20

Të punësuarit në shërbimin profesional që janë të përfshirë në zbatimin e procedurave për furnizim publik, nuk duhet të pranojnë dhurata ose përfitim tjetër nga pjesëmarrësit në procedurat për furnizim publik, për të mos u ekspozuar ndaj supozimeve për punë të pandershme gjatë kryerjes së procedurave për furnizim publik.

VIII. MBROJTJE DHE SHFRYTËZIM EKONOMIK E DIKASTEREVE

Neni 21

Anëtarët e Këshillit, drejtori i Agjencisë dhe zëvendës drejtori i Agjencisë, si dhe të punësuarit, po bëjnë çdo përpjekje për shfrytëzim efikasës dhe ekonomik të mjeteve materiale dhe pajisjeve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Neni 22

Anëtarët e Këshillit, drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë dhe të punësuarit nuk duhet të shfrytëzojnë dikasteret e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në mënyrë joracionale ose për realizim të interesit personal,

Neni 23

Anëtarët e Këshillit, drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë dhe të punësuarit, për punë jashtë detyrave të punës në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, nuk i shfrytëzojnë dikasteret e Agjencisë, pa njoftuar paraprakisht dhe leje nga Agjencia.

IX. SHFRYTËZIMI I ORARIT TË PUNËS DHE HAPËSIRAVE

Neni 24

I punësuarit obligohet t'i përmbahet fillimit dhe mbarimit të orarit të punës në Agjencion, për kryerjen e detyrave zyrtare.

I punësuarit, obligohet të regjistrojë kohën e punës për çdo hyrje-dalje nga hapësirat e punës të Agjencisë.

Neni 25

Gjatë orarit të punës, vendi i punës nuk duhet të lëshohet me përjashtim të rasteve të detyrimeve zyrtare jashtë selisë së Agjencisë ose në raste kur është njoftuar udhëheqësi i sektorit me miratim të tij.

Nëse punonjësi pengohet të vijë në punë në një ditë të caktuar ose ka arsye për vonesë gjatë ardhjes në punë ose për t'u larguar më herët nga puna, i punësuarit obligohet për arsye kohe të njoftojë dhe të kërkojë miratim nga udhëheqësi përkatës i sektorit,

Neni 26

I punësuarit duhet punët zyrtare t'i organizojë, planifikojë, caktojë dhe detyrimet e punës t'i kryejë në kohë, në mënyrë të drejtë dhe me përgjegjësi.

Detyrat e punës nuk duhet në mënyrë të panevojshme dhe pa arsye të shtyhen.

X. SJELLJA PROFESIONALE DHE PERSONALE

Neni 27

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë, drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë dhe të punësuarit, në kryerjen e funksioneve të tyre dhe detyrimeve të punës duhet të sillen me ndershmëri, sinqeritet dhe përgjegjësi.

Neni 28

Anëtarët e Këshillit, drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë dhe të punësuarit, është e nevojshme të sillen në mënyrë korrekte dhe të denjë ndaj kolegëve, duke respektuar dinjitetin dhe qëndrimin e tyre, edhe nëse mendimet janë të ndryshme.

Anëtarët e Këshillit, drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë dhe të punësuarit, detyrohen të veprojnë drejtë, në mënyrë të paanshme dhe profesionale.

Neni 29

Të punësuarit nuk duhet të shtyjnë ose t'ia besojnë punën e tyre një punonjësi tjetër, vetëm nëse për atë ekziston arsyetim, dhe me miratim paraprak nga udhëheqësi përkatës i sektorit,

XI. PARAQITJA PROFESIONALE

Neni 30

Në Agjenci praktikohet kodes i punës joformal për veshje, që ka për qëllim të mundësojë punë komode të punësuarve dhe për të promovuar një pamje profesionale.

Në evente oficiale, rekomandohet kodeki i veshjeje më serioze.

Anëtarët e Këshillit, drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë dhe të punësuarit në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, pamja e tyre duhet të tregojë profesionalizëm dhe rregullsi.

Neni 31

Anëtarët e Këshillit, drejtori i Agjencisë, zëvendës drejtori i Agjencisë dhe të punësuarit në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, kanë liri në vendim dhe përzgjedhje të veshjes që do të mbajnë, duke pasur parasysh pranueshmërinë dhe papranueshmërinë për një lloj të caktuar.

Veshjet e mëposhtme janë përgjithësisht të papranueshme, të cilat:

- përdoret zakonisht në shtëpi, në bare nate ose për aktivitete sportive;
- zbulon shumë kurrizin, gjoksin, shpatullat, stomakun ose veshje e brendshme; _ e tejdukshme ose me prerje të madhe dhe dekolte _ përmban fjalë, shprehje ose imazhe që synojnë të jenë fyese ose të papranueshme për të punësuarit e tjerë dhe për bashkpunëtorët e tjerë të Agjencisë; _e cila bën të pamundur qëndrimin në publik (fustane ose veshje të brendshme me gjatësi të papërshtatëshme).

Bizhuteria, makiashi, parukeria dhe manikyri duhet të jenë ashtu të përzgjedhur të tregojnë mirësjellje dhe rregullsi dhe për t'u përshtatur me pamjen e punës.

XI.DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 32

Me ditën e hyrjes në fuqi i këtij Kodeksi, ndalet vlefshmëria e Kodeksit të sjelljes, nga anëtarët e Këshillit të Agjencisë dhe të punësuarve në shërbimin profesional të Këshillit për radiodifuzion në Republikën e Maqedonisë nr.02-J687/2 datë 23.6.2006.

Neni 33

Ky Kodeks hyn në fuqi me ditën e miratimit, dhe do të shpallet në tabelën e shpalljeve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe në web faqen e Agjencisë.

Nr.01-2762/1
06.04.2015
Skopje

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetar i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

DATE: _____

Page No. _____
